



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2022:277459  
Datë: 09.08.2024  
Numri i dokumentit: 06034713

**P.nr.14/2023**

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal**, me gjyqtarin e vetëm gjykues Lulzim Paçarizi, si dhe sekretaren juridike Behije Karaçica, në çështjen penale ndaj të akuzuarit M.B.për shkak të veprës penale zjarr vënie nga neni 322 par.2 të KPRK-së, ndërsa sipas aktakuzës PP.nr.946/22 të dt.16.02.2023, pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar, të dt. 18.07.2024, ku prezent ishin Prokurori i shtetit Venera Shala, i akuzuari M.B.me mbrojtësin e tij av. Nuhi Krasniqi me autorizim, i dëmtuari M.B.me dt.22.07.2024, shpallë, ndërsa me dt.09.08.2024, e përpilon këtë:

## A K T G J Y K I M

**I AKUZUARI: M.B.**, nga i ati M. dhe e ëma B. e lindjes K., i lindur më datën ..., në fshatin M., me vendbanim në M. Lagjia e G., me nr. personal:..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa martuar, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike.

## Ë S H T Ë F A J T O R

Për shkak se me datë 10.05.2022 rreth orës 13:40 minuta në Rr. „S.R.” në Malishevë, me dashje e ka ndez zjarrin në pronën e luajtshme të dëmtuarit M.B.në atë mënyrë që ditën kritike pasi që i dëmtuari e kishte parkuar automjetin e tij të tipit VW Golf me targa ... në parkingun e restorantin D., i pandehuri M. B. pa ndonjë arsye shkon tek vendi i lartcekur dhe pasi e vëren veturën e vëllaut të tij, afrohet dhe merr disa letra në mbeturina dhe të njëjtat i vendos nën anën e djathtë të automjetit dhe i ndez, ku më pas shpërthen zjarri në veturë dhe fillon të digjet derisa arrin zjarrfikësit dhe e shuajnë zjarrin.

- Me këto veprime ka kryer veprën penale Zjarrvënie nga neni 322 par.2 të KPRK-së.

Andaj gjykata konform nenit 4, 7, 17, 38, 39, 40, 46, 47, 48, 49, 69, 71 par.1 pika 1.3, nenit 322 par.2 të KPRK-së, si dhe nenit 364 të KPPK-së të njëjtit i`a shqipton:

## G J Y K O N

Ashtu që e gjykon me dënim burgimi në kohëzgjatje prej gjashtë **(6) muajve**, ndërsa gjykata dënimin e shqiptuar nuk do ta ekzekuton në afatin kohor prej **një (1) viteve**, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

**URDHËROHET** Shërbimi Sprovues i Kosovës në Gj. që ta mbikëqyrë dhe ta ekzekutojë dënimin me kusht, ashtu që **OBLIGOHET** i akuzuari që të mbajë kontaktin me Shërbimin Sprovues të Kosovës në Gj..

Obligohet i akuzuarit në emër të paushallit gjyqësor gjykatës t'ia paguajnë shumën prej njëzet (20) euro, për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej njëzet (20) euro, ndërsa shpenzime te procedurës penale nuk ka pasur, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën ekzekutimi do të bëhet me detyrim.

## A r s y e t i m

### 1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP.nr.946/22 të dt.16.02.2023, e ka akuzuar M.B., për shkak të veprës penale zjarr vënie nga neni 322 par.2 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor si dhe administrimit të provave, të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj në bazë të ligjit.

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me dt.18.07.2024, ku prezent kanë qenë, prokurori e shtetit Venera Shala, i akuzuari M.B.me mbrojtësin e tij av. Nuhi Krasniqi me autorizim dhe i dëmtuari M.B.andaj ka pasur kushte për mbajtjen e shqyrtimit fillestar.

I akuzuari M.B. pas konsultimit paraprak me mbrojtësin e tij av. Nuhi Krasniqi, deklarohej i fajshëm për veprën penale për të cilën ngarkohet, duke shtuar se me vjen keq për rastin i cili ka ndodhur, për të cilin jam penduar, i kërkoj falje vëllait F., andaj kërkoj nga gjykata që të merren parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit dhe te me shqiptohet një dënim më i butë, pasi që i kam kushtet e vështira ekonomike, jam me tretman të vazhdueshëm mjekësor, ku edhe mezi arrij që ti blej barnat, po ashtu i premtoj gjykatës që në të ardhmen do te jem më i kujdesshëm që mos të kryej kurrfarë vepre penale.

Mbrojtësi i të akuzuarit, av. Nuhi Krasniqi deklaron: Pas konsultimit paraprak me të mbrojturin tim , duke ia shpague efektet dhe benifitet e pranimit të fajësisë, i mbrojturi im e pranoj në mënyrë vullnetare fajësinë, andaj kërkoj nga gjykata që të aprovohet pranimi i fajësisë, po ashtu me rastin e matjes dhe caktimit të dënimit kërkoj nga gjykata duke marr parasysh gjendjen ekonomike të dobët, pranimin e fajësisë në mënyrë vullnetare, po ashtu është në tretman mjekësor, dhe rrethanat tjera lehtësuese ti shqiptohet një dënim sa më i butë.

I dëmtuari F. B.deklaron se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, nuk i bashkangjitet ndjekjes penale dhe nuk parashtron kërkesë pasurore juridike, unë ndaj të akuzuarit respektivisht vëllait tim M. përkujdesëm pasi që i njëjti nuk i ka kushtet ekonomike dhe unë detyrohem që ti ndihmoj si në aspektin material pasi që është i pa punë po ashtu vazhdimisht përkujdesëm pasi që nuk e ka gjendjen e mirë shëndetësore, po ashtu deklaroj se dëmi nuk ka qenë i madh në veturë, vetura ka qenë e vjetër.

Prokurori i shtetit Venera Shala, deklaron: Nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit M.B., duke marr parasysh se i njëjti i ka kuptuar natyrën, pasojat dhe benifitet e pranimit të fajësisë, gjithashtu pranimi i fajësisë pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij është bërë në mënyrë vullnetare si dhe ky pranim i fajit gjen mbështetje në faktet e çështjes të përshkruar në aktakuzë, e po ashtu aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore apo gabime faktike. Andaj kërkoj nga gjykata që gjatë përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit të merr parasysh pranimin e fajësisë nga i akuzuari M.B., pendimin dhe premtimin e tij se në të ardhmen nuk do ti përsërisë veprimet e njëjta e gjithashtu të ketë parasysh edhe gjendjen e tij shëndetësore. Ndërsa sa i përket rrethanave rënduese i lë në vlerësim të gjykatës.

## 2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 242 të KPPRK-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoj se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

## 3. Gjendja faktike e vërtetuar.

Duke u bazuar në këto që u ceken me lart gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

-se i akuzuari M.B. ka kryer veprën penale zjarr vënie nga neni 322 par.2 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjendjen e këtillë faktike e mori në tërësi ashtu siç ishte përcaktuar në aktakuzë dhe në provat të cilat i përmbante aktakuza, e ato janë:

- Raporti i oficerit B. F., datë 10.05.2022;
- Raporti i kqyerjes së vendit të ngjarjes, datë 10.05.2022;
- Deklarata e të dëmtuarit M.B.e dhënë në polici me dt.10.05.2022 dhe në prokurori me dt.29.12.2022;
- Deklarata e të pandehurit M.B., e dhënë në polici me dt.10.05.2022 dhe në prokurori me dt.29.12.2022;
- Fotoalbumi nga Njësia e Forenzikës me numër ...., datë 10.05.2022;
- Si dhe shkresat tjera në lëndë.

#### 4. Elementet e veprës penale.

1. Në nenin 322 par.2 të KPRK-së, është parashikuar se: *Kushdo që ndez zjarrin apo shkakton shpërthimin me qëllim të dëmtimit apo asgjësimit të banesës së banuar ose veturës në shfrytëzim nga personi tjetër, dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.*

#### 5 Vendimi i gjyqtarit të vetëm gjykues.

Duke u bazuar në këto që u ceken me lart gjyqtari i vetëm gjykues të akuzuarin M.B.e ka shpallur fajtor për veprën penale për të cilën ngarkohet, nga se në veprimet e tij të përshkruara si në dispozitiv të aktgjykimit, formohen të gjitha elementet e veprës penale zjarr vënia nga neni 322 par.2 të KPRK-së, për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta gjykoj në bazë të ligjit, e me parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

#### 6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit.

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të pandehurit duhet ti shqiptohet dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryesit si dhe përgjegjësinë penale të tij, gjykata me rastin e matjes së dënimit pati parasysh rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit si në kuptim të nenit 69 të KPRK-ës të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit, pranimin e fajësisë, është i gjendjes së dobët ekonomike, është i pa punë, jeton me ndihmat që i merre nga vëllai, është me tretman të vazhdueshëm mjekësor, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej kurrfarë vepre penale, i dëmtuari F. B. vëllai i tij ka deklaruar se nuk i bashkangjitem ndjekjes penale, nuk parashtrij kërkesë pasurore juridike, raportet i kemi të mira dhe unë përkujdesëm për të pasi që vëllai im gjendjen shëndetësore nuk e ka të mirë e po ashtu edhe dëmi ka qenë i vogël pasi që vetura ka qenë e vjetër, kështu që duke zbatuar institutin e zbutjes konorm nenit 71 par.1 pika 1.3 të KPP-së ka ardhur në përfundim se me dënimin burgimi me kusht në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, ndërsa gjykata

dënimin e shqiptuar nuk do ta ekzekuton në afatin kohor prej një (1) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nëse i akuzuari nuk kryen veprë të re penale, mund të arrihen qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

I dëmtuari M.B.nuk është udhëzuar në kontestin civil, pasi që i njëjti nuk i është bashkangjitur ndjekjes penale.

#### 7. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale.

Vendimi paushallin gjyqësor dhe shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 449 par.1 dhe 2 të KPPK-së, ndërsa vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marr konform nenit 39 parg.3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit nr.05/L036 për kompensimin e viktimave të krimit.

Me sa u tha me lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e konform nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal**  
**P.nr.14/2023, me dt.22.07.2024.**

Sekretarja juridike  
Behije Karaçica

Gjyqtari i vetëm gjykues  
Lulzim Paçarizi

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, nëpërmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.